



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:254030  
Datë: 11.03.2025  
Numri i dokumentit: 06973443

C.nr.8941/24

GJYKATA THEMELORE PRISHTINË – Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil, gjyqtari Ibrahim Maloku, me bashkëpunëtoren profesionale Edita Kolgeci, duke vendosur në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh.V. nga ..., të cilin e përfaqëson G. C., avokat në ..., kundër të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, me seli në Prishtinë, në çështjen juridike për anulimin e vendimit, kthim në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, pas mbajtjes së seancës së shqyrtimit kryesor të mbajtur me datë 18.02.2025, kurse me datën 11.03.2025, mori dhe përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I. APROVOHET si e bazuar kërkesëpadia e paditësit, Sh.V., ashtu që ANULOHET si i kundërligjshëm vendimi i të paditurës Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” me seli në Prishtinë, nr.92, i datës 16.01.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës.

II. DETYROHET e paditura Universiteti i Prishtinës, “Hasan Prishtina” me seli në Prishtinë, që paditësin Sh.V. ta kthejë në vendin e punës Profesor asistent në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit me të drejta dhe normë të plotë, si dhe t’ia kompensojë të gjitha pagat nga data e nxjerrës së vendimit nr.92, datë 16.01.2017, e deri me datën 30.09.2024, dhe atë në emër të pagës neto shumë prej 92,495.39 Euro, në emër të kontributit pensional të punësuarit shumë prej 5,287.71 Euro, në emër të kontributit pensional të punëdhënësit shumë prej 5,287.71 Euro dhe tatimin në pagë në shumë prej 7,970.93 Euro, me kamatë ligjore prej 8 % nga dita e ushtrimit të padisë datë 08.03.2017 e deri në pagesën definitive, të gjitha këto në afat prej 7 dite nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit ligjor.

III. DETYROHET e paditura Universiteti i Prishtinës, “Hasan Prishtina” me seli në Prishtinë, që paditësit Sh.V., t’ia paguaj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 2,378.00 Euro, të gjitha këto në afat prej 7 ditës pas plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të përmbarrimit ligjor.

## A r s y e t i m

Paditësi përmes të autorizuarit të tij, ka ushtruar padi pranë kësaj Gjykate, me datë 08.03.2017, për anulimin e vendimit, kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave. Lidhur me këtë lëndë, gjykata ka zhvilluar procedurën kontestimore në drejtim të vendosjes në mënyrë meritore dhe me datë 24.06.2021 ka nxjerrë Aktgjykimin C.nr.521/17 përmes të cilit e ka aprovuar si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit. Në bazë të procedurës ankimore të zhvilluar në bazë të ankesës së të paditurës, Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, përmes aktvendimit AC.nr.10120/2021, të datës 03.04.2024, ka vendosur që të APROVOHET si e bazuar ankesa e të paditurës Universiteti i Prishtinës dhe të PRISHET Aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë C.nr.521/2017 i datës 24.06.2021 dhe lënda ti kthehet të njëjtës në rigjykim dhe rivendosje. Ndërsa pika II e dispozitivit të këtij aktgjykimi të mbetet i pa shqyrtuar.

Pas pranimi të lëndës, analizimit të vërejtjeve të dhëna nga Gjykata e Apelit të Kosovës në Prishtinë, dhe me qëllim të eliminimit të të njëjtave, në rigjykim Gjykata ka procedura me çështjen në fjalë duke caktuar dhe mbajtur shqyrtimin përgatitor dhe shqyrtimin kryesor.

Paditësi, kundër të paditurit me paraqitjen e padisë me datë 08.03.2017, kishte kërkuar anulimin e vendimit, kthimin në vendin e punës dhe kompensimin e pagave, të cilën e ka precizuar në seancën e shqyrtimit kryesor, ku çështjen e ka paraqitur si në vijim: Paditësi që nga viti 2003 është pjesëtar i stafit akademik në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit fillimisht si asistent dhe nga viti 2009 si profesor asistent, gradë kjo e fituar në bazë të kushteve të parapara me statutin e Universitetit – të paditurit. Paditësi në vitin 2015, aplikon për avancim akademik në konkursin e shpallur nga Rektori dhe pas përfundimit të procedurës së konkursit, rizgjidhet në thirrjen akademike të njëjtë edhe për katër vite të tjera dhe nënshkruan kontratë 4 vjeçare me normë të plotë sipas thirrjes akademike dhe atë nga 30.09.2016 deri më 30.09.2020. I padituri me datën 16.01.2017 nxjerr vendim për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me arsyetimin se paditësi nuk ka përmbushur detyrat dhe përgjegjësitë e përcaktuara në kontratë dhe nuk ka zbatuar vendimin e Këshillit Drejtues nr.92, datë 13.10.2016. Paditësi gjatë tërë kohës që nga momenti i zgjedhjes si asistent, pastaj zgjedhjes si profesor asistent dhe në fund rizgjedhjes prapë në thirrjen e njëjtë, nuk ka nënshkruar kontratë të rregullt me asnjë institucion tjetër arsimor dhe asnjëherë nuk është deklaruar ndryshe në Agjencinë e Kosovës për Akreditim përveç se si staf akademik i rregullt i të paditurit me që rast vërteton se asnjëherë nuk është shkelur kontrata me paditësin dhe vendimi nr.2/901 i datës 13.10.2016. Paditësi në afat ligjor me datën 30.10.2017 ushtron ankesë ndaj vendimit për ndërprerjen e marrëdhënies së punës dhe që nga kjo datë e deri në dorëzimin e padisë në gjykatë, nuk ka pranuar asnjë përgjigje në lidhje me ankesën. Paditësi në asnjë rast nuk ka bërë shkeljen e kontratës, vendimet e të paditurit përkundrazi punët e kryera për të paditurin janë shumë më shumë se ato të parapara me kontratë duke përfshirë këtu përgatitjen e komplet dokumentacionit për procesin e akreditimit të Fakultetit të Edukimit Fizik dhe Sportit, mbrojtjen e programeve para ekspertëve ndërkombëtar etj. Po ashtu paditësi në asnjë rast nuk ka munguar në mbledhjet e organeve të ndryshme të fakultetit, siç janë Këshilli Mësimor, komisionet e ndryshme etj. Bazuar në këto fakte vërtetoj se vendimi i të paditurit është i pa bazuar, i kundërligjshëm, diskriminues dhe në kundërshtim me aktet e vet të paditurit. Andaj

ka kërkuar që Gjykata të nxjerr Aktgjykim me të cilin e aprovon në tërësi si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit Sh.V. dhe Anulon vendimin nr.92 të datës 16.01.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, të detyrohet i padituri Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina” që paditësin ta kthejë në vendin e punës Profesor asistent në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportiv me të drejta dhe normë të plotë si dhe të ia kompensoj të gjitha pagat nga data e nxjerrjes së vendimit nr.92. të datës 16.01.2017 e deri më datën 30.09.2024 dhe atë në emër të pagës neto shumë prej 92.495.39 Euro neto, në emër të kontributit pensional të punësuarit shumë prej 5.287.71 Euro, në emër të kontributit pensional të punëdhënësit shumë prej 5,287.71 dhe tatimin në pagë në shumë prej 7,970.93, të gjitha këto me kamatë ligjore prej 8% në vit e cila do të llogaritet nga data e ushtrimit të padisë datë 08.03.2017 e deri ne pagën definitive. Shpenzimet e procedurës i ka kërkuar dhe ato në shumë prej 2.228.00 Euro; 208 Euro për padi, për 6 seanca gjyqësore nga 270 Euro gjithsej 2.228.00 Euro dhe për tri ekspertiza financiare shumë prej 400 Euro, të gjitha ne afat prej 7 ditësh nga plotfuqishmëria e aktgjykimit. Pranë të njëjtave kanë mbetur edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor dhe në fjalën përfundimtare, dhe ka shtuar se nga përgjigja e AAB në pyetje të gjykatës vërtetohet se paditësi gjatë periudhës 2014, 2015 dhe 2016 ka qenë i angazhuar në këtë institucion në punë sekondare, ndërsa tek e paditura në marrëdhënie të rregullt të punës. Gjatë fjalës përfundimtare ka kërkuar edhe shpenzimet për taksë gjyqësore për padi në shumë prej 150.00 Euro.

E paditura përmes të autorizuarit të tij, gjatë shqyrtimit kryesor dhe në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se, mbetet në tërësi pranë deklarimeve, provave të dorëzuara si dhe pranë akteve juridike me të cilat funksionon e paditura, ku edhe i ka mbështetur vendimet e nxjerra. Paditësi kishte deklaruar në formularin e deklaramit të datës 20.10.2016, se pagë primare me normë të plotë, siç e përcakton edhe rregullorja për të ardhurat personale me nr. 2/486 datë 11.09.2017 do ta ketë me të paditurin (UP), duke përfshirë, “6 orë në javë ligjërata në semestrin e parë dhe po ashtu 6 orë ligjërata në semestrin e dytë”, por në të njëjtin formular kishte deklaruar edhe angazhimin e dytë si pagë sekondare me Kolegjin AAB, e që edhe në këtë kolegji kishte deklaruar, “6 orë në javë ligjërata në semestrin e parë dhe po ashtu 6 orë në javë në semestrin e dytë”. Paditësi po ashtu nga periudha e deklaramit të tij e edhe në ditët e sotme mban edhe pozitë menaxhuese në marrëdhënie të rregullt me AAB përkatësisht si zv. Rektor, gjegjësisht prorektor për çështje mësimore dhe është mësimdhënës i rregullt në këtë kolegji. Prandaj e paditura kishte njoftuar me kohë paditësin se nuk mund të ketë normë të plotë edhe me UP edhe me Kolegjin AAB, sipas deklaramit që vet kishte bërë. E paditura kishte kërkuar nga paditësi që i njëjti ta ofrojë dorëheqjen në cilësi të prorektorit nga Kolegji AAB, dhe të dëshmonte se përveç UP-së nuk do të ketë ndonjë marrëdhënie të rregullt pune, i njëjti nuk kishte ofruar dorëheqjen, i cili edhe sot e tutje qëndron në pozitën menaxhuese të Kolegjit AAB. Paditësi përmes përfaqësuesit të tij në fjalën përfundimtare ka deklaruar se vendimi i rektorit është marr pa asnjë paralajmërim paraprak. Kjo nuk qëndron pasi që vet paditësi ka pasur për obligim ta respektojë fillimisht kontratën e punës, e që në atë kontratë pika 12 e qartëson se: Personat në marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të kenë kontratë tjetër punësimi me normë të plotë me ndonjë institucion tjetër. Paditësi ka qenë i njoftuar me vendimin e Këshillit Drejtues të UP-së 2/901 i datës 13.10.2016, i cili vendim i ka obliguar të gjithë personelin që të përmbahen kushteve dhe kriteret e tij. Paditësi që nga themelimi i krijimit të marrëdhënies së punës ka qenë i njoftuar me kriteret e Statutit të UP-së, prandaj dispozita e nenit 170 pika 1, “Personeli në marrëdhënie të rregullt pune

nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet tjetër”. Andaj i ka kërkuar kësaj Gjykate që ta refuzojë në tërësi kërkesë padinë e paditësit si të pa bazuar. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Me qëllim të vlerësimit të drejtë dhe vërtetimit të plotë të gjendjes faktike lidhur me çështjen konkrete juridike, në shqyrtimin kryesor – publik të datës 18.02.2025, me propozimin e ndërgjyqësve bëri administrimin e provave dhe atë: me shikimin dhe leximin e Vendimit nr.1/312 i datë 16.05.2007, me shikimin dhe leximin e Vendimit nr.3/320 i datës 04.11.2016, me shikimin dhe leximin e Kontratës së Punës nr.3/687 e datës 24.11.2016 dhe nr.4/95 e datës 29.12.2016, me shikimin dhe leximin e Vendimit nr.92 i datës 16.01.2017 për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, me shikimin dhe leximin e Kontratës së Punës nr.ref.1531/2016 e datës 29.07.2016, me shikimin dhe leximin e Deklaratës për vitin akademik 2016-2017 e datës 20.10.2016, me shikimin dhe leximin e listës së personelit akademik në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, me shikimin dhe leximin e evidencës mbi vijimin e personelit akademik prej datës 14.11.2016 e deri më 19.01.2017, me shikimin dhe leximin e Ekspertizës nga lëmia e aktuaristikë e datës 13.07.2020 nga eksperti A. B., me shikimin dhe leximin e Ekspertizës financiare të datës 15.04.2021 nga ekspertja M. M., me shikimin dhe leximin e Konkursit nr.prot. 804 i datës 14.05.2021, me shikimin dhe leximin e Vendimit nr.prot. 2/901 i datës 13.10.2016, dhe me leximin dhe shikimin e dëshmisë nga Administrata Tatimore për vitet 2014, 2015 dhe 2016, përgjigja e Kolegjit AAB e dorëzuar në Gjykatë me datën 01.10.2024, si dhe plotësimi i ekspertizës financiare e datës 18.11.2024 e përpiluar nga ekspertja financiare M. M.

Pasi që Gjykata bëri vlerësimin e secilës provë veç e veç dhe të gjithave se bashku, mbështetur në dispozitat nga neni 8, i Ligjit për Procedurën Kontestimore, dhe pasi pati parasysh rekomandimet e Gjykatës së Apelit arriti në përfundimin se në këtë çështje juridike kontestuese duhet vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi, se kërkesëpadia e paditësit është e bazuar.

Në çështjen kontestuese ndërmjet palëve ndërgjyqëse, nuk ishte kontestues fakti se paditësi ka qenë i punësuar te e paditura dhe se më pas marrëdhënia e tij e punës është ndërprerë nga ana e paditurës përmes Vendimit nr. prot. 92, të datës 16.01.2017. Ky fakt është pranuar nga të dyja palët dhe si i tillë nuk përbën çështje kontestuese në këtë procedurë.

Megjithatë, kontesti ndërmjet palëve ndërgjyqëse lidhet me bazën juridike të kërkesëpadiës e cila përqendrohet kryesisht në vlerësimin e ligjshmërisë së ndërprerjes së marrëdhënies së punës së paditësit, si dhe në vlerësimin e saktësisë dhe lartësisë së pretendimeve të parashtruara nga paditësi përmes kërkesëpadiës. Palët kanë paraqitur qëndrime të kundërta lidhur me arsyetimin juridik mbi të cilin është mbështetur vendimi për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, si dhe mbi përputhshmërinë e këtij vendimi me dispozitat ligjore të aplikueshme në rastin konkret.

Në këtë drejtim, është thelbësore të shqyrtohet nëse ndërprerja e marrëdhënies së punës është realizuar në përputhje me procedurat e përcaktuara me ligj dhe aktet nënligjore përkatëse, si dhe nëse arsyetimi i dhënë për këtë veprim nga e paditura është i bazuar dhe i arsyeshëm. Gjithashtu, shqyrtimi duhet të përfshijë edhe analizën e pretendimeve të paditësit në raport me dëmet e pretenduara financiare të përfshira në kërkesëpadinë e tij.

Në bazë të kësaj, çështja kërkon trajtim të kujdesshëm të provave materiale, për të përcaktuar nëse vendimi i paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës së paditësit është në përputhje me kuadrin ligjor të aplikueshëm, si dhe për të përcaktuar të drejtën e paditësit për kthimin në vendin e punës, si dhe kompensim e pagave, të kërkuara përmes padisë së ngritur.

Për të arsyetuar vendimin e marr, Gjykata, në vijim, do të analizojë dhe vlerësojë me kujdes të gjitha provat e administruara gjatë procedurës gjyqësore, duke i trajtuar ato si individualisht ashtu edhe në mënyrë të përbashkët, në përputhje me parimet e administrimit të provave dhe peshimit të tyre sipas dispozitave ligjore përkatëse. Gjykata do të kryejë një vlerësim të plotë dhe objektiv të secilës provë të dorëzuar, duke e krahasuar atë me provat e tjera për të përcaktuar relevancën, besueshmërinë dhe fuqinë e tyre provuese

Paditësi, me Vendimin nr. ref.1/312 të datës 16.05.2007, ishte emëruar asistent nga e paditura UP “Hasan Prishtina” në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit për lëndën Lëvizjet e Njeriut, ndërsa me Vendimin nr.3/320 të datës 04.11.2016, ishte zgjedhur profesor asistent, në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, ku edhe ka lidhur kontratën e punës me nr.prot.3/687, të datës 24.11.2016, me kohëzgjatje nga data 30.09.2016 e deri më 30.09.2020. Nga provat e administruara, gjykata vërtetoi se paditësi me të paditurën kanë qenë në marrëdhënie pune të rregullt në kohëzgjatje prej afërsisht 10 vjet.

Nga Kontrata e Punës me honorar nr.ref. 1531/2016 e datës 29.07.2016 e lidhur në mes të Kolegjit AAB dhe Sh.V.t, Gjykata gjeti se paditësi kishte lidhur marrëdhënie pune në kohë të caktuar nga data 01.07.2016 e deri me datën 30.06.2017, me Kolegjin AAB në pozitën Këshilltar dhe Mësimdhënës, me status jo të rregullt (honorar).

Nga deklarata për vitin akademik 201617 e dhënë për Agjencinë e Kosovës për Akredimit (AKA), e dhënë me datën 20.10.2016, vërtetohet se paditësi në këtë Agjenci është deklaruar si punësuar me orar të plotë – Full Time në Universitetin e Prishtinës – Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, kurse në orar jo të plotë – Part Time në Kolegjin AAB – Fakultetin për Kulturë Fizike dhe Sport. Për këtë i njëjti me po të njëjtën datë pra 20.10.2016, ka paraqitur edhe deklaratë lidhur me vërtetësinë e të dhënave të paraqitura në këtë Agjencion.

Nga deklarata e datës 20.10.2016, vërtetohet se paditësi nën përgjegjësinë morale, administrative dhe penale ka deklaruar se gjatë orarit të rregullt të punës 08:00-16:00, nuk ka kontratë tjetër punësimi me normë të plotë jashtë Universitetit të Prishtinës dhe se angazhimet e tij brenda dhe jashtë Universitetit të Prishtinës janë dhe atë në UP në pozitën e Profesorit 6 orë në semestrin e parë dhe 6 orë në semestrin e dytë, ndërsa në Kolegjin AAB 6 orë në semestrin e parë dhe 6 orë në semestrin e dytë.

Nga lista e personelit akademik në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe të Sportit, të deklaruar lidhur me marrëdhënien e punës në UP dhe Institucionet tjera jashtë UP-së, vërtetohet se paditësi Sh.V., me numër rendor 7, si marrëdhënie primare të punës ka deklaruar marrëdhënien e punës me të paditurën, kurse si marrëdhënie sekondare të punës ka deklaruar marrëdhënien e punës me Kolegjin AAB.

Nga përgjigja e Kolegjit AAB e dorëzuar në këtë Gjykatë, me datën 01.10.2024, në përgjigje në pyetjet e parashtruara nga Gjykata, ky Kolegj e ka njoftuar Gjykatën se paditësi Sh.V. nga data 01.10.2013 e deri me datën 30.06.2015, ka qenë i angazhuar në pozitën Konsulet për akreditim dhe mësimdhënësi në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, kurse nga data 01.07.2017 e deri 31.12.2017, ka qenë i angazhuar në pozitën Këshilltar i Rektorit dhe Mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit. Gjatë kësaj periudhe kohore, kanë theksuar se paditësi ka qenë i angazhuar me honorar – pagë sekondare. Po ashtu ka theksuar se gjatë semestrit veror mars, prill dhe maj 2014 i njëjti ka mbajtur 6 orë ligjërata në javë, në semestrin dimëror tetor, nëntor dhe dhjetor 2014, i njëjti ka mbajtur 5 orë ligjërata në javë. Gjatë semestrit veror mars, prill dhe maj 2015 i njëjti ka mbajtur 6 orë ligjërata në javë, në semestrin dimëror tetor, nëntor dhe dhjetor 2015, i njëjti ka mbajtur 5 orë ligjërata në javë. Gjatë semestrit veror mars, prill dhe maj 2016 i njëjti ka mbajtur 2 orë ligjërata në javë, në semestrin dimëror tetor, nëntor dhe dhjetor 2016, i njëjti ka mbajtur 4 orë ligjërata në javë. Me këtë përgjigje Kolegji AAB, ka bashkangjitur edhe listat e pagave për të punësuar për vitin 2014, 2015, 2016, oraret e ligjëratave në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, kontratat e punës për paditësin, të vitit 2013, 2014, 2015, si dhe 2016, si dhe formën e deklarimit të paditësit në ATK.

Nga vendimi nr.prot.92, i datës 16.01.2017, i lëshuar nga Universiteti i Prishtinës “Hasan Prishtina”, në Prishtinë, gjegjësisht rektori M. D., me pikën I të tij, është përcaktuar se prof.ass.dr. Sh.V., mësimdhënës në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, për shkak mos përmbushjes së përgjegjësisve dhe detyrave të përcaktuara me kontratë, moszbatim të vendimit të Këshillit Drejtues nr.2/901, të datës 13.10.2016, i ndërpritet marrëdhënia e punës, sipas kontratës nr.3/687, të datës 24.11.2016. Në pikën II të këtij vendimi, është përcaktuar se i përmenduri duke filluar nga data 01.01.2017 nga Universiteti i Prishtinës, do të kompensohet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit të përcaktuar sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së. Me pikën III, është përcaktuar se Zyrtaret për çështje akademike, obligohen për semestrin veror 2016/17, të përmendurin t’a pajisin me kontratë honorar F-3 në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm. Me pikën IV të këtij vendimi, është përcaktuar se vendimi në fjalë hynë në fuqi në ditën e nënshkrimit. Nga arsyetimi i vendimit në fjalë për ndërprerjen e marrëdhënies së punës, është përmendur fakti se bazuar në dëshmit e siguruara në faqen zyrtare të Kolegjit AAB, shihet qartë se paditësi Sh.V., është zgjedhur në cilësi të prorektorit për çështje mësimore në këtë kolegj. Kundër vendimit në fjalë paditësi kishte bërë ankesë me datën 30.01.2017, i pranuar në UP me numër 05-246.

Gjykata duke vepruar sipas propozimit të palës paditëse, ka caktuar marrjen e provës me ekspertizë nga lëmia e financave, ku nga mendimi dhe konstatimi i ekspertit A. B. në ekspertizën e datës 13.07.2020, është konstatuar se fitimi i humbur i paditësit për shkak të ndërprerjes së marrëdhënies së punës tek e paditura me datë 16.01.2017 arrin vlerën, për tërë periudhën e kaluar prej datës 16.01.2017 e deri me datë 30.06.2020, arrin shumën prej 3,449.00 euro, kontributi pensional në këto paga arrin në 403.00 euro i cili duhet transferuar në Trustin e kursimeve pensionale paditësit. Tatimi në këto paga arrin në 383.00 euro të cilin e paditura duhet të ia transferoj ATK-së. Ndërsa për periudhën e ardhshme prej 01.07.2020 e tutje deri sa për këtë të

ekzistojnë kushtet ligjore, gjegjësisht deri në skadencën e kontratës, arrin shumën në nga 872.80 euro bruto në muaj.

Nga ekspertiza tjetër financiare dhe nga mendimi dhe konstatimi në ekspertizën e datës 15.04.2021, nga ekspertja M. M., si dhe sqarimeve në seancë, ekspertja ka konstatuar se mbi bazën e shtjellimeve të lëndës, për periudhën kontestuese nga 01.01.2017 e deri në nxjerrjen e kësaj ekspertize, sipas llogaritjeve Sh.V., kishte me i realizuar pagat prej: Bruto paga 58.562.71 euro, neto paga që do të duhej të i paguhej punëtorit është në shumë prej 51,214.42 euro, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin Pensional në emër të punëtorit është 2,928.14 euro, kontributi pensional që duhet paguar në Trustin Pensional në emër të punëdhënësit është 2,928.14 euro, si dhe tatimi në paga që duhet paguar në Buxhetin e Kosovës është shuma prej 4,420.16 euro. Në procedurën sipas rivendosjes Gjykata kishte marrë aktvendimin e datës 22.10.2024 për caktimin e ekspertit financiar me qëllim të plotësimit të ekspertizës financiare nga ekspertja M.M. e datës 15.04.2021, me qëllim të llogaritjes së pagave për periudhën e mbetur nga data 16.04.2021 deri më 30.09.2024. Në ekspertizën plotësuese të datës 18.11.2024 ekspertja financiare kishte nxjerrë konstatim se për periudhën kontestimore nga data 16.04.2021 deri më datë 30.09.2024, paditësi Sh.V. kishte për të realizuar pagat si në vijim: Pagë bruto në shumë prej 47,191.31 Euro, pagën neto prej 41,280.97 Euro, kontributin pensional në emër të punëtorit në shumën prej 2,359.57 Euro, kontributin pensional në emër të punëdhënësit në shumën prej 2,359.57 Euro, dhe tatimin në pagë prej 3,550.77 Euro. Edhe gjatë shqyrtimit gjyqësor të seancës kryesore të mbajtur me 18.02.2025 ekspertja financiare kishte prezantuar dhe mbrojtur ekspertizën në fjalë. Ekspertizës dhe plotësimit të saj, së ekspertës financiare M. M., Gjykata në tersi ia ka falë besimin, pasi që e njëjta ishte e punuar në mënyre profesionale dhe në përputhje me provat tjera të bashkangjitura në shkresat e lëndës.

Me dispozitën e nenit 70 paragrafi 1 të Ligjit të punës, nr.03/L-212 parashihet që: “1. *Punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit me një periudhë paralajmërimi, atëherë kur: 22 1.1. ndërprerja e tillë arsyetohet për arsye ekonomike, teknike ose organizative; 1.2. i punësuarit nuk është më i aftë t’i kryejë detyrat e punës; Më tej pika 1.6 parasheh që “Punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit pa periudhën e kërkuar të paralajmërimit të ndërprerjes, atëherë kur: 1.6.1. i punësuarit është fajtor për përsëritjen e një sjelljeje më pak serioze ose të shkeljes së detyrimeve; 1.6.2. performanca e të punësuarit mbetet e pakënaqshme përkundër paralajmërimit me shkrim”, ndërsa paragrafi 2 i po të njëjtit nen parasheh që: “Punëdhënësi mund ta ndërpresë kontratën e punës në bazë të nënparagrafit 1.6. të paragrafit 1. të këtij neni vetëm atëherë kur i punësuarit ka marrë përkrahimin në formë të shkruar të performancës së pakënaqshme, një afat të përcaktuar kohor brenda të cilit i punësuarit duhet ta përmirësojë performancën e vet, si dhe një deklaratë se dështimi për përmirësimin e performancës do të rezultojë me largim nga puna pa asnjë paralajmërim të mëtejshëm me shkrim”. Me dispozitën e nenit 70 parag.3 të Ligjit të Punës është paraparë që: “Punëdhënësi duhet që të mbajë takim me të punësuarin për t’ia shpjeguar atij/asaj ndërprerjen e kontratës së punës ose me qëllim që t’ia dorëzojë paralajmërimin, i punësuarit ka të drejtë që të shoqërohet nga një përfaqësues sipas dëshirës së vet”. Me dispozitën e nenit 170 të Statutit të Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina, Prishtinë, është paraparë që: “Personeli në*

*marrëdhënie të rregullt pune nuk mund të ketë kontratë tjetër të punësimit me normë të plotë në ndonjë universitet tjetër.”.*

Me pikën 2 të Vendimit të Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës nr.prot.2/901, të datës 13.10.2016, përcaktohet: *“Personeli akademik që përveç Universitetit të Prishtinës ka edhe një marrëdhënie tjetër pune në ndonjë institucion brenda apo jashtë vendi, OJQ, kompani publike apo private, avokaturë, noteri, përmbarues privat dhe të ngjashme, obligohet që deri më 31.10.2016, të përcaktohet nëse do të ketë marrëdhënie të rregullt pune me Universitetin e Prishtinës apo jashtë universitetit.”.* Ndërsa pika 3 e vendimit në fjalë, përcakton: *“Personei akademik i cili përcaktohet për marrëdhënie të rregullt pune me pagë primare në një institucion tjetër jashtë UP-së, nga Universiteti i Prishtinës do të kompensohet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit i përcaktuar sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së”*, kurse pika 4 e vendimit në fjalë përcakton: *“Personeli akademik me thirrje të prof.asistent, prof.asociar dhe prof. i rregullt i cili mbanë poste publike jashtë UP-së përmes institucionit të konkursit publik, nga Universiteti i Prishtinës do të kompensohet vetëm për orët e mbajtura gjatë periudhës semestrale, në cilësi të bashkëpunëtorit të jashtëm, por jo më shumë se fondi i orëve të honorarit i përcaktuar sipas Rregullores në fuqi për të ardhurat personale të personelit akademik të UP-së.”.*

Nga provat e administruara, Gjykata vlerëson se vendimi i të paditurës, Universitetit të Prishtinës “Hasan Prishtina”, në nr.prot.92, të datës 16.01.2017, për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me paditësin Sh.V. është i pabazuar dhe i kundërligjshëm. Ky përfundim mbështetet në faktin se nuk janë përmbushur kërkesat ligjore dhe procedurale të përcaktuara me Ligjin e Punës nr.03/L-212, si dhe me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, të cilat e rregullojnë marrëdhënien e punës dhe kushtet për ndërprerjen e saj.

Fillimisht, sipas nenit 70 paragrafi 1 të Ligjit të Punës, punëdhënësi mund t’ia ndërpresë kontratën e punës të punësuarit për arsye ekonomike, teknike apo organizative, apo në rastet kur i punësuarit nuk është më i aftë për të kryer detyrat e punës. Megjithatë, në rastin konkret, ndërprerja e marrëdhënies së punës është mbështetur në supozimin se paditësi ka pasur marrëdhënie pune të rregullt në një institucion tjetër, përkatësisht në Kolegjin AAB, pa ndonjë analizë të mjaftueshme faktike dhe juridike për të mbështetur këtë konstatim.

Për më tepër, pika 1.6 e nenit 70 të Ligjit të Punës parasheh se ndërprerja e kontratës pa periudhë paralajmërimi mund të bëhet vetëm në rastet kur i punësuarit përsërit një sjellje të papranueshme ose nuk e përmirëson performancën e tij pas një paralajmërimi me shkrim. Në këtë rast, nuk është e dokumentuar që paditësit i është dorëzuar ndonjë përkrahje e performancës së pakënaqshme apo që i është caktuar një afat kohor për përmirësimin e saj, siç kërkohet në paragrafin 2 të këtij neni. Mungesa e një procedure të tillë e bën të kundërligjshëm aktin e ndërprerjes së kontratës pa një bazë paraprake të qartë.

Gjithashtu, nga provat rezulton se paditësi kishte raportuar pranë Agjencisë së Kosovës për Akreditim (AKA) se ka marrëdhënie pune me orar të plotë në Universitetin e Prishtinës dhe orar



të pjesshëm në Kolegjin AAB, duke respektuar dispozitat e nenit 170 të Statutit të Universitetit të Prishtinës. Gjykata konsideron se përderisa paditësi kishte deklaruar qartazi marrëdhëniet e tij të punës dhe nuk ka të dhëna se kishte shkelur detyrimet e tij ndaj të paditurës gjatë orarit të punës, atëherë pretendimi i të paditurës për shkelje të dispozitave të Statutit dhe vendimit të këshillit drejtues, është i pabazuar.

Vendimi i Këshillit Drejtues të Universitetit të Prishtinës nr.prot.2/901, i datës 13.10.2016, kërkon që personeli akademik të deklarohet nëse do të mbajë marrëdhënie të rregullt pune me Universitetin e Prishtinës apo me ndonjë institucion tjetër deri më 31.10.2016. Nga provat, Gjykata vëren se paditësi ka respektuar këtë dispozitë duke raportuar statusin e tij të punës në mënyrë transparente dhe në kohë. Andaj, ndërprerja e marrëdhënies së punës duke u thirrur në dispozitat e këtij vendimi është e pabazuar, pasi që nuk është vërtetuar se paditësi ka shkelur detyrimet e tij për raportim dhe përmbushjen e detyrave të punës si Profesor Asistent në Universitetin e Prishtinës.

Gjithashtu, nga provat e dorëzuara në gjykatë nga Kolegji AAB, përfshirë kontratat e punës dhe listat e pagave, del qartë se marrëdhënia e punës e paditësit në këtë institucion ka qenë me status jo të rregullt dhe me angazhim të pjesshëm (honorar), gjë që nuk bie në kundërshtim me dispozitat e Statutit të Universitetit të Prishtinës, të cilat ndalojnë vetëm punësimin me orar të plotë në ndonjë institucion tjetër.

Për këto arsye, Gjykata arrin në përfundim se vendimi i të paditurës për ndërprerjen e marrëdhënies së punës me paditësin është i pabazuar në ligj dhe në fakte. Andaj, në përputhje me dispozitat ligjore dhe staturore të lartpërmendura, Gjykata ka vendosur që vendimi i të paditurës nr.prot.92, të datës 16.01.2017, duhet të anulohet, andaj, nga këto arsye është vendosur sikurse në pikën I të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Në bazë të provave të administruara në këtë rast, Gjykata ka konstatuar se paditësit Sh.V.t, në mënyrë të kundërligjshme i është ndërprerë marrëdhënia e punës si Profesor asistent në Fakultetin e Edukimit Fizik dhe Sportit, sipas kontratës nr.3/687, të datës 24.11.2016. Duke u bazuar në dispozitën e nenit 80, paragrafi 1, pika 1.2 të Ligjit të Punës, Gjykata ka vendosur që paditësi të rikthehet në pozitën e tij të mëparshme me të drejta dhe normë të plotë pune, dhe të kompensohet për të gjitha pagat e humbura nga data e nxjerrjes së vendimit nr.92, datë 16.01.2017, deri më 30.09.2024. Në bazë të ekspertizave financiare të kryera nga ekspertja financiare M.M, është përcaktuar se gjatë kësaj periudhe paditësi kishte për të realizuar gjithsej pagat neto në shumën prej 92,495.39 Euro, kontributin pensional të punësuarit në shumën prej 5,287.71 Euro, kontributin pensional të punëdhënësit në shumën prej 5,287.71 Euro dhe tatimin në pagë në shumën prej 7,970.93 Euro. Ekspertizat financiare janë paraqitur në dy faza: e para, më 15.04.2021, për periudhën nga 01.01.2017 deri më 15.04.2021, ku përcaktohet se paditësi kishte për të realizuar pagën neto prej 51,214.42 Euro, kontributin pensional të punësuarit në shumën prej 2,928.14 Euro, kontributin pensional të punëdhënësit në shumën prej 2,928.14 Euro dhe tatimin në pagë prej 4,420.16 Euro. Faza e dytë, plotësimi i ekspertizës së datës 18.11.2024, për periudhën nga 16.04.2021 deri më 30.09.2024, përcakton shumën e pagave neto prej 41,280.97 Euro, kontributin pensional të punësuarit në shumën prej 2,359.57 Euro, kontributin

pensional të punëdhënësit në shumën prej 2,359.57 Euro dhe tatimin në pagë prej 3,550.77 Euro. Nga këto arsye u vendos sikurse në pikën II të dispozitivit të këtij aktgjykimi.

Lidhur me lartësinë e kamatës së llogaritur prej 8 %, Gjykata vendosi në kuptim të nenit 382 të LMD-së, meqenëse e paditura ka rënë në vonesë në përmbushjen e detyrimit, prandaj obligoj të paditurën që, përveç borxhit kryesor, të paguaj edhe kamatën përkatëse, duke llogaritur nga dita e ushtrimit të padisë datë 08.03.2017, e deri në pagesën definitive.

Gjykata gjatë vendim marrjes, ka patur parasysh pretendimet e të paditurës, se në arsyetimin e vendimit të kontestuar është theksuar se "bazuar në dëshminë e siguruar në faqen zyrtare të Kolegjit AAB, shihet qartë se prof. ass. dr. Sh.V. është zgjedhur në cilësi të prorektorit për çështje mësimore në këtë kolegji", Gjykata konsideron se një provë e tillë nuk është bindëse për të mbështetur këtë konstatim. Për të vërtetuar një marrëdhënie juridike, siç është marrëdhënia e punës, Gjykata u referohet dokumenteve juridike përkatëse, të tilla si kontratat e punës, të cilat shërbejnë për të legjitimuar dhe vërtetuar një marrëdhënie të tillë. Duke qenë se e paditura nuk ka paraqitur një provë të tillë, Gjykata nuk mund ta trajtojë këtë pretendim si fakt vendimtar për rrethanat e çështjes. Faktet e pretenduara, siç mund të ishte ushtrimi i detyrave të prorektorit nga paditësi për të paditurën, duhet të jenë të formalizuara përmes dokumenteve juridike për të pasur efektin e tyre provues. Në këtë rast, gjykata nuk mund të kufizohet dhe të vendosë bazuar vetëm në një gjendje faktike, për një kontest që lidhet me marrëdhënien e punës.

Gjithashtu, gjykata ka pranuar përgjigjen nga Institucioni ku paditësi ka qenë i angazhuar për periudhën kontestuese, konkretisht Kolegji AAB, më datë 01.10.2024. Në këtë përgjigje është sqaruar se gjatë viteve 2014, 2015 dhe 2016, paditësi ka qenë i angazhuar në pozitën e Konsulentit për akreditim dhe mësimdhënës në Fakultetin e Kulturës Fizike dhe Sportit, nga data 01.10.2013 deri më 30.06.2015. Ndërsa nga data 1 Korrik 2017 deri më 31 Dhjetor 2017, paditësi ka qenë i angazhuar si Këshilltar i Rektorit dhe mësimdhënës në të njëjtin Fakultet. Të gjitha këto angazhime janë kryer mbi bazë honorari dhe me paga sekondare. Kontratat e punës së paditësit me Kolegjin AAB, për periudhën nga viti 2013 deri në vitin 2016, kanë qenë vetëm për angazhime me honorar dhe nuk ekzistojnë kontrata të tjera për ndonjë pozitë të rregullt pune.

Pretendimet e të paditurës se paditësi ka krijuar marrëdhënie të rregullt pune me një institucion tjetër në kundërshtim me dispozitën 170 të Statutit rezultojnë të pabazuara. Kjo mbështetet edhe nga deklarimi i siguruar nga Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), sipas të cilit paditësi ka pasur marrëdhënie të rregullt pune vetëm me të paditurën dhe nuk ka pasur një marrëdhënie të dytë të rregullt me ndonjë institucion tjetër. Sipas tabelës së siguruar nga ATK, marrëdhënia e punës me të paditurën figuron si primare, e cila paraqitet me një shenjë plus (+) në kategorinë "primare", ndërsa marrëdhënia me Kolegjin AAB paraqitet me një shenjë minus (-) në të njëjtën kategori. Kjo dëshmon se gjatë periudhës kontestuese, paditësi ka qenë i angazhuar me honorar dhe jo me një marrëdhënie të rregullt pune me Kolegjin AAB, gjë që nuk përbën shkelje të dispozitave përkatëse të Statutit. Prandaj, nga arsyet e dhëna si më lartë, pretendimet e të paditurës Gjykata i gjeti si të pabazuara.

Vendimin që pala e paditur ti bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën e nenit 449, 452 dhe 463 të Ligjit të Procedurës Kontestimore dhe tarifës së OAK-së. Lartësia e shpenzimeve të procedurës të aprovuara i referohet shpenzimeve edhe atë: përpilimin e padisë 208 Euro, 150.00 Euro për taksë gjyqësore për padi, për 6 seanca gjyqësore nga 270 euro gjegjësisht 1,620.00 euro, për ekspertizën financiare të punuar nga eksperti A. B. shumën prej 150.00 Euro, për ekspertizën financiare të punuar nga ekspertja M.M. shumën prej 150 euro, për plotësimin e ekspertizës financiare të punuar nga ekspertja M.M shumën prej 150.00 Euro, gjegjësisht 400.00 euro për ekspertiza financiare, gjithsej shumën prej 2,378.00 Euro.

Nga të lartcekurat Gjykata vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRISHTINË**  
- Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Civil -  
C.nr.8941/24, datë 11.03.2025

Gjyqtari,  
Ibrahim Maloku

**KËSHILLË JURIDIKE:** Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi. Ankesa i drejtohet Gjykatës së Apelit të Kosovës, përmes kësaj Gjykate.